

URDHËR
Nr. 296, datë 2.5.2019

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E FIERZËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhja në treg ose për konsum i të gjitha llojeve të peshqve të familjes së krapit në liqenin e Fierzës për periudhën 1.5.2019 deri më 31.5.2019.

2. Ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën breg/liqenore prej 150 ml nga bregu për periudhën 1.6.2019 deri më 30.6.2019.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të.

4. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-në, e cila ushtron aktivitet peshkimi në këtë liqen.

5. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në vartësi të së cilës është Sektori i Inspektimit e Kontrollit të Peshkimit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të qarkut Kukës, që të monitorojnë zbatimin e Planit Operativ të Veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore të bashkive Kukës, Has, Tropojë dhe Fushë-Arrës, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Kukësit e Shkodrës, si dhe me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit të qarkut Kukës e Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi